

VENDIM
Nr. 391, datë 28.5.2026

PËR MIRATIMIN E KODIT TË ETIKËS SË VULLNETARIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 37, të ligjit nr. 94/2025, “Për vullnetarizmin”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Kodit të Etikës së Vullnetarit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ngarkohet ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

KODI I ETIKËS SË VULLNETARIT

Neni 1
Vullnetarizmi

Vullnetarizmi është një veprimtari me vlerë të lartë shoqërore, që kontribuon në përmirësimin e cilësisë së jetës, zhvillimin e personalitetit njerëzor dhe ndërtimin e një shoqërie demokratike, të drejtë dhe solidare. Ai bazohet mbi vullnetin e lirë, ndjenjën solidare dhe kryhet pa përfitim material.

Neni 2
Qëllimi

Kodi i Etikës së Vullnetarit (në vijim “Kodi”) ka për qëllim të vendosë rregulla formale për sjelljen e vullnetarëve, të ofruesve dhe të përfituesve të vullnetarizmit, në përputhje me ligjin nr. 94/2025, “Për vullnetarizmin”.

Neni 3
Subjekti

Kodi zbatohet për të gjithë personat, që ushtrojnë veprimtari vullnetare në territorin e Republikës së Shqipërisë, si për ofruesit dhe përfituesit e vullnetarizmit.

Neni 4
Parimet themelore

Kodi bazohet mbi parimet e integritetit, të paanshmërisë, të përgjegjshmërisë, transparencës e të respektit për dinjitetin njerëzor. Këto parime udhëheqin interpretimin dhe zbatimin e çdo neni të këtij Kodi.

Neni 5
Trajtimi me respekt

Vullnetari trajtohet me mirësjellje, respekt dhe dinjitet nga të gjithë personat e lidhur me procesin e vullnetarizmit.

Neni 6 **Partneriteti**

Ofruesi i vullnetarizmit formulon rregulla të qarta, që garantojnë partneritetin e tij me vullnetarin dhe i njeh këto si pjesë të pandashme të të drejtave të vullnetarit.

Neni 7 **Informacioni**

1. Vullnetari ka akses në informacionin e ofruesit të vullnetarizmit për politikat, rregulloret dhe planet e punës.
2. Vullnetari merr informacion të detajuar për detyrat, kohën e angazhimit dhe burimet e nevojshme.
3. Vullnetari ka të drejtë të marrë informacion të shkruar për të drejtat dhe detyrimet e tij.

Neni 8 **Mosdiskriminimi**

1. Vullnetari dhe përfituesi nuk diskriminohen për asnjë nga shkaqet e përcaktuara në nenin 9, të ligjit nr. 4/2025, përfshirë gjininë, moshën, orientimin seksual, besimin fetar, aftësinë e kufizuar, prejardhjen etnike apo çdo shkak tjetër.
2. Në rast pretendimi për diskriminimin në ushtrimin e së drejtës për kryerjen ose përfitimin e vullnetarizmit sipas ligjit, personat e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndjekin procedurën e ankimit, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Neni 9 **Pozicioni i punës**

Vullnetari ka të drejtë të zgjedhë një pozicion, që përputhet me aftësitë, prirjet dhe eksperiencën e tij, në përputhje me nevojat e ofruesit të vullnetarizmit.

Neni 10 **Koha e punës vullnetare**

Në përputhje me nenin 12, të ligjit nr. 94/2025, “Për vullnetarizmin”, dhe duke pasur parasysh politikat, qëllimet e kërkesat e ofruesit të vullnetarizmit, vullnetari, në bashkëpunim me ofruesin e vullnetarizmit, përcakton sasinë e kohës që ai i kushton kryerjes së punës vullnetare.

Neni 11 **Rritja profesionale**

Vullnetari ka të drejtë për zhvillim profesional dhe trajnim, sipas nevojave të ofruesit dhe preferencave të tij, në përputhje me natyrën e punës që do të kryejë sipas parashikimeve të shkronjës “d”, të pikës 1, të nenit 31, të ligjit nr. 94/2025, “Për vullnetarizmin”.

Neni 12 **Trajnimi i vullnetarëve**

Ofruesi i vullnetarizmit ka detyrimin të sigurojë trajnimin e vullnetarëve përpara fillimit të aktivitetit dhe në mënyrë periodike gjatë angazhimit, në përputhje me natyrën e punës dhe rreziqet e mundshme. Trajnimi përfshin njohuritë bazë mbi të drejtat, detyrimet, sigurinë dhe etikën e vullnetarizmit.

Neni 13

Kushtet e kryerjes se vullnetarizimit

Vullnetari ka të drejtë të ketë kushte të përshtatshme në punë. Atij i vihen në dispozicion të gjitha burimet dhe kushtet fizike të nevojshme për të kryer vullnetarizmin në një mjedis pune të sigurt. Nevojat e vullnetarit me aftësi të kufizuara (PAK) merren në konsideratë në mënyrë të veçantë.

Neni 14

Siguria dhe menaxhimi i rrezikut

Vullnetari është i detyruar të respektojë rregullat e sigurisë dhe të raportojë çdo incident që ndodh gjatë aktivitetit. Ofruesi i vullnetarizmit siguron mjedis pune të sigurt dhe udhëzime të qarta për menaxhimin e rreziqeve.

Neni 15

Vlerësimi

Në përfundim të kontratës, ofruesi i vullnetarizmit vlerëson kontributin e vullnetarit.

Neni 16

Kryerja e detyrës

Vullnetari ka për detyrë të kryejë punën e tij me përkushtim dhe profesionalizëm.

Neni 17

Dhuratat dhe kompensimi

Vullnetari nuk pranon dhurata apo përfitime materiale nga përfituesit e shërbimeve. Lejohet vetëm kompensimi i shpenzimeve të përcaktuara në nenin 14, të ligjit nr. 94/2025.

Neni 18

Konflikti i interesit

Vullnetari ka për detyrë të shmangë konfliktet e interesit. Vullnetari, që e gjen veten e tij në një konflikt interesi, duhet ta vetëdeklarojë atë. Vullnetari shmang përfshirjen në çdo formë vetëpunësimi ose biznesi privat, që konkurren me shërbimet apo programet e ofruesit të vullnetarizmit, ku ai ushtron vullnetarizmin.

Neni 19

Ndikimi i vullnetarëve të tjerë

1. Vullnetari nuk përdor pozicionin e tij si vullnetar për të influencuar vullnetarët e tjerë, stafin ose ofruesin e vullnetarizmit.

2. Vullnetari, që mund të gjendet në një pozicion autoriteti, nuk duhet të abuzojë, të ushtrojë influencë të papërshtatshme apo të kërcënojë një vullnetar tjetër apo anëtar të organizatës/ofruesit të vullnetarizmit.

Neni 20

Përdorimi i pijeve alkoolike dhe i substancave narkotike gjatë detyrës

Vullnetari nuk duhet të paraqitet nën efektin e pijeve alkoolike apo të substancave narkotike, si dhe nuk duhet t'i përdorë ato gjatë kryerjes së vullnetarizmit.

Neni 21

Komunikimi dhe ndërveprimi me të tjerët

1. Vullnetari nuk përdor fjalë të papërshtatshme dhe nuk shqetëson vullnetarët e tjerë, pjesëtarë të ofruesit të vullnetarizmit apo përfituesin e vullnetarizmit.

2. Vullnetari ndërvepron me vullnetarët e tjerë, stafin e ofruesit të vullnetarizmit, përfituesin e vullnetarizmit dhe anëtarët e publikut në mënyrë profesionale, të sjellshme, dinjitoze, të respektueshme, të drejtë e të barabartë.

3. Vullnetari nuk vë në lojë apo në siklet një punonjës apo një vullnetar tjetër, përfshirë përdorimin e fjalëve ofenduese ose të sjelljeve, që dëmtojnë marrëdhënien e vullnetarizmit.

4. Vullnetari nuk sillet në mënyrë të tillë që shqetëson, poshtëron ose krijon një ambient jo të rehatshëm pune për vullnetarët e tjerë.

5. Vullnetari respekton parimin e trajtimit të barabartë dhe të mosdiskriminimit, sipas nenit 9, të ligjit nr. 94/2025.

6. Vullnetari respekton parimin e mosdiskriminimit dhe të ndalimit të shqetësimit, përfshirë shqetësimin seksual, sipas neneve 9 e 10, të ligjit nr. 94/2025.

7. Vullnetari trajton këdo me dinjitet e respekt.

Neni 22

Procedura e shqyrtimit të ankesave

1. Çdo vullnetar, i cili pretendon se është trajtuar në kundërshtim me këtë Kod, ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë strukturës përgjegjëse të ofruesit të vullnetarizmit.

2. Ankuesi e paraqet ankesën me shkrim pranë strukturës përgjegjëse të ofruesit të vullnetarizmit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data kur ka marrë dijeni për veprimin ose sjelljen e pretenduar. Ankesa duhet të përmbajë:

- a) identitetin e ankuesit;
- b) përshkrimin e fakteve dhe të sjelljes së pretenduar;
- c) kohën dhe vendin e ngjarjes;
- ç) emrat e personave të përfshirë, nëse njihen;
- d) çdo dokument ose provë mbështetëse.

3. Në rast se ankesa paraqitet e paplotë, struktura përgjegjëse kërkon plotësimin e saj brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e ankesës. Ankuesi duhet të plotësojë të metat brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e njoftimit.

4. Struktura përgjegjëse shqyrton ankesën në mënyrë të paanshme, konfidenciale dhe në përputhje me parimet e procesit të rregullt.

5. Personi, ndaj të cilit është paraqitur ankesa, njoftohet për përmbajtjen e saj brenda 5 (pesë) ditëve nga fillimi i procedurës dhe ka të drejtë të paraqesë shpjegime, prova dhe pretendime brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e njoftimit.

6. Gjatë shqyrtimit të ankesës, struktura përgjegjëse administron prova dhe dëgjon palët, kur kjo vlerësohet e nevojshme për sqarimin e rrethanave.

7. Struktura përgjegjëse merr vendim të arsyetuar me shkrim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga paraqitja e plotë e ankesës dhe ua njofton palëve brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e tij.

8. Kundër vendimit, pala e interesuar ka të drejtë të kërkojë rishqyrtimin e tij pranë drejtuesit të ofruesit të vullnetarizmit ose strukturës përgjegjëse të përcaktuar në rregullat e brendshme, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

9. Ofruesi i vullnetarizmit merr masat e nevojshme organizative për zbatimin e procedurave të përcaktuara në këtë nen.

Neni 23 **Masat disiplinore**

1. Pas përfundimit të procedurës së shqyrtimit, sipas nenit 22, të këtij Kodi, kur konstatohet shkelje e dispozitave të tij, struktura përgjegjëse e ofruesit të vullnetarizmit mund të marrë këto masa disiplinore:

- a) kërkim faljeje;
- b) trajnim shtesë;
- c) paralajmërim me shkrim;
- ç) pezullim të përkohshëm nga veprimtaria vullnetare, deri në 30 (tridhjetë) ditë;
- d) përfundim të kontratës së vullnetarizmit.

2. Masa disiplinore caktohet në përpjesëtim me natyrën dhe rëndësinë e shkeljes, duke marrë në konsideratë:

- a) pasojat e shkeljes;
- b) shkallën e përgjegjësisë;
- c) përsëritjen e shkeljes;
- ç) sjelljen e mëparshme të vullnetarit;
- d) rrethanat lehtësuese ose rënduese.

3. Masa disiplinore jepet me shkrim, është e arsyetuar dhe i njoftohet vullnetarit brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e saj.

4. Vullnetari ka të drejtë të ankohet ndaj masës disiplinore pranë drejtuesit të ofruesit të vullnetarizmit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit të masës. Ankesa shqyrtohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga paraqitja e saj dhe vendimi i arsyetuar i njoftohet vullnetarit brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e tij.

Neni 24 **Ofruesi i vullnetarizmit**

Ofruesi i vullnetarizmit ka për detyrë:

- a) të vlerësojë dhe të njohë rolin e çdo vullnetari;
- b) të shpjegojë rolin e vullnetarit ndaj përfituesve të shërbimeve;
- c) të edukojë stafin për rëndësinë e vullnetarizmit;
- ç) të sigurojë që pajisjet apo ambientet fizike, ku ushtrohet vullnetarizmi, të jenë të sigurt për vullnetarët;
- d) të respektojë aftësitë e ndryshme të vullnetarëve;
- dh) të respektojë motivet e tyre për t'u angazhuar;
- e) të garantojë konfidencialitetin e të dhënave personale;
- ë) të mbështesë rritjen personale e profesionale të vullnetarëve;
- f) të respektojë të drejtat, dinjitetin dhe vlerën e çdo personi të përfshirë;
- g) të sigurojë që eksperiencia e vullnetarizmit të jetë pozitive dhe e dobishme për shoqërinë.

Neni 25 **Mekanizmat e zbatimit e të monitorimit të Kodit**

Zbatimi i Kodit monitorohet nga strukturat përgjegjëse të ofruesit të vullnetarizmit. Procedurat dhe afatet për shqyrtimin e ankesave përcaktohen në rregulloret e brendshme, duke garantuar transparencë dhe paanshmëri.

Neni 26

Përfituesi i vullnetarizmit

1. Përfituesi i shërbimeve të vullnetarizmit ka të drejtë të trajtohet me respekt, dinjitet dhe pa diskriminim, në përputhje me nenin 9, të ligjit nr. 94/2025, “Për vullnetarizmin”.
2. Përfituesi informohet qartë mbi rolin e vullnetarit dhe natyrën e shërbimeve që ofrohen.
3. Përfituesi ka të drejtë të paraqesë ankesa ose sugjerime lidhur me cilësinë e shërbimeve të marra, sipas procedurave të përcaktuara nga ofruesi i vullnetarizmit.
4. Përfituesi respekton vullnetarin dhe nuk ndërmerr veprime, që cenojnë dinjitetin, sigurinë apo integritetin e tij.

Neni 27

Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale

Vullnetari ka detyrimin të ruajë konfidencialitetin e informacionit dhe të të dhënave personale, që merr gjatë ushtrimit të veprimtarisë. Shpërndarja e tyre pa autorizim është e ndaluar edhe pas përfundimit të marrëdhënies së vullnetarizmit.

Neni 28

Dispozita të fundit

1. Vullnetari duhet të njohë dhe të sillet në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 94/2025, “Për vullnetarizmin”, në Kodin e Etikës së Vullnetarit dhe në rregullat e brendshme të ofruesit të vullnetarizmit.
2. Kodi i Etikës së Vullnetarit vendoset në vende të dukshme në zyrat e ofruesve të vullnetarizmit dhe shpërndahet te çdo vullnetar.
3. Ofruesit e vullnetarizmit raportojnë mbi zbatimin e Kodit pranë institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, sipas mekanizmave të përcaktuar në ligj.